



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

BORDI

RREGULLORE

MBI PËRMBAJTJEN E RREGJISTRIT TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE

Miraturar me vendimin e Bordit nr. 78, datë 29.06.2011

Neni 1 Objekti

Kjo rregullore përcakton përmbajtjen e regjistrave të Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, të cilat mbahen nga Autoriteti i Mbrojtjes Financiare.

Regjistrat përfshijnë:

- a) Regjistrin e Fondeve të Investimit;
- b) Regjistrin e Shoqërive të Investimit.

Neni 2 Baza ligjore

Kjo rregullore është nxjerrë në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 10198, datë 10.12.2009, “Për Sipërmarrjet e Investimeve Kolektive”, (këtu e më poshtë “Ligji”). Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim dhënë atyre në Ligj.

Neni 3 Regjistri i Fondeve të Investimit

Në regjistrin e fondeve të investimit do të mbahen të dhënat e mëposhtme:

1. Kodi i identifikimit të fondit përbëhet nga tre pjesë:

- a. kodi që tregon llojin e sipërmarrjes (FI – për fondin e investimit);
- b. kodi që tregon llojin e fondit, duke u nisur nga politika e investimit:
 - para dhe ekuivalentët e saj (kodi C),

- aksione (kodi A),
- obligacione (kodi O),
- i balancuar (kodi B).

c. numrin rendor të regjistrimit në regjistër;

2. Emri i Fondit të Investimit dhe data e miratimit nga Autoriteti.

4. Të dhëna mbi shoqërinë e administrimit të fondit të investimit:

- emri i shoqërisë së administrimit të fondit të investimit;
- numri i regjistrimit të shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit (QKR);
- numri i Licencës së dhënë nga Autoriteti;
- data e miratimit të licencës të shoqërisë së administrimit;
- adresa;
- personi i kontaktit;
- anëtarët e këshillit të administrimit të shoqërisë së administrimit.

Neni 4

Regjistri i Shoqërive të Investimit

Në regjistrin e shoqërive të investimit do të mbahen të dhënat e mëposhtme

1. Kodi i identifikimit të shoqërisë së investimit që përbëhet nga katër pjesë:

a. kodi që tregon llojin e sipërmarrjes (SI).

- kodi që tregon nënlojin e shoqërisë së investimit:
 - Shoqëri investimi me ofertë publike (OP);
 - Shoqëri investimi me ofertë private (OJP).

b. kodi që tregon politikën e investimit:

- para dhe ekuivalentët e saj (kodi C);
- aksione (kodi A);
- obligacione (kodi O);
- të balancuara (kodi B);
- në tituj të pa listuar (kodi TJL);
- prona të paluajtshme (kodi PP);
- të dhëna të tjera siç mund të përcaktohen nga Autoriteti.

c. numrin rendor të regjistrimit në regjistër.

2. Emrin e shoqërisë së investimit duke përfshirë:

- numrin e regjistrimit të shoqërisë së investimit (në QKR);
- numrin e licencës të dhënë nga Autoriteti;
- adresën;
- personi i kontaktit;
- kapitalin fillestar të shoqërisë së investimit;

- vlerën nominale për aksion.

3. Datën e miratimit të licencës së shoqërisë së investimit.

4. Të dhëna mbi shoqërinë e administrimit të shoqërisë së investimit:

- emri i shoqërisë së administrimit;
- numri i regjistrimit të shoqërisë (në QKR);
- numri i licencës të dhënë nga Autoriteti;
- data e miratimit të licencës për shoqërinë e administrimit;
- adresa;
- personi i kontaktit;
- anëtarët e këshillit të administrimit të shoqërisë së administrimit.

Neni 5

Mënyra e dhënies së kodit të identifikimit

Autoriteti do t'i japë një kod identifikimi unik, të pandryshueshëm dhe të papërdorshëm secilës sipërmarrjeje në momentin e regjistrimit, sipas mënyrës së përcaktuar në nenin 3 dhe 4 të kësaj rregulloreje, sipas kronologjisë së krijimit të tyre.

Neni 6

Akresi në regjistër

Autoriteti mundëson akses publik të lirshëm dhe falas në regjistrin e sipërmarrjeve kolektive.

Neni 7

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elisabeta GJONI